



## Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

25/05/2023

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 23.5.2023, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elvana Çiçolli bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elvana Çiçolli, gjyqtare në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Alma Faskaj, znj. Etleda Çiftja relatore, znj. Suela Zhegu anëtare do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 25.5.2023

***Vendimi i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KPK-së në rubrikën e njoftimeve në linkun:***  
***<https://kpk.al/njoftim-per-seancen-degjimore-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-elvana-cicolli/57/>***